

Nuhi Veselaj

B U L Ë Z A
T Ë
P Ë R S H E N J U R A

(vjersha të një "babamësuesi" kushtuar stinës rinore)

Prishtinë, shkurt 2000

Falënderim:

Ukë punërinuesit
e Shkëlqim vetëvepruesit
që përjetësuan veprën
e Babamësuesit!

P a r a t h ë n i e

Shumica nga këto "Bulëza të përshenjura" (vjersha të një "babamësuesi" kushtuar stinës rinore) nën atmosferën e krijuar në fund të viteve `60, u lindën paralel me disa vjersha të përmbledhjes "Ther me pupël", të cilat si dy vëllime të veçanta i pata dorëzuar për vlerësim e botim në redaksinë e Ndërmarrjes botuese "Rilindja" të Prishtinës në vitin 1971. Mirëpo edhe pse vlerësimet e recensuesve (S. Mumxhiu dhe Rr. Dedaj), sadokudo, dolën pozitive (me ndonjë vërejtje për përmirësim), ato nuk mund të botoheshin, ngase autori i tyre atëherë, nga regjimi në fuqi, ripaditej si person "politikisht i papështatshëm" dhe si i tillë, jo vetëm se iu mor ditari nga duartë që të mos punojë me të rinjtë (nxënësit), por edhe iu ndalua punësimi në institucionet përkatëse shoqërore-politike e si rrjedhim pati edhe mosbotimin i veprave letrare, pesë prej të cilave atëherë i qenë ofruar shtypit.

Kjo është arsyeja që vjershat e tilla, edhe pse të botuara aty-këtu më përpara, duhej të gjumonin dhe të prisnin që mbase një ditë e bardhë do të vinte edhe për to.

Tashti me titull të modifikuar nga "Bula gazi" në "Bulëza të përshenjura", sërish u vlerësuan dhe po dalin përpara lexuesve. Në këtë përmbledhje, në krahasim me të parën, numri i vjershave të tilla shënon rritje, edhe pse nuk e di se a ka shënuar rritje edhe sa i përket cilësisë artistike e asaj përmbajtësore.

Sidoqoftë, të gjithë lexuesve (të të gjitha grupmoshave), por sidomos ju të rinjve dhe të rejave adoleshentë (qoftë të periudhës së rinisë së hershme, qoftë asaj të vonë), që unë, si atëherë si "babamësues" si tash si "gjyshmësues", ju konsideroj si nxënës a më mirë si fëmijë të mi (tash si nipa e mbesa) të përshenjor, ju dëshiroj çaste të këndshme jo vetëm gjatë leximit, por gjatë tërë jetës, në mënyrë që disponimi e mirëkuptimi të zënë vend parësor në botën tuaj, fizike, shpirtërore e mendore, ndërsa brengat e mosmarrëveshjet (që gjithsesi çdo stinë e jetës i ka), të jenë sa më të lehta, kurse ato të rëndat të hidhen tej e përtej thepave të kohës, në harresë të pakthyeshme!

Është e vërtetë se në këtë vepër është vënë re a është kapur në vargje sipërfaqësisht, nga jashtë, vetëm ndonjë rast, cikërrim i vogël i "stinës rinore", ngase bota e brendshme e kësaj moshe, që ndjehet individualisht, është shumë-shumë më e madhe, prandaj mbetet që secili nga ju të vlerësojë, të gjykojë, madje edhe të provojë të shprehë ndjesinë që e përjeton, qoftë me gjuhën e mendjes, qoftë me atë të zemrës, madje edhe më mirë se që është bërë në këtë përmbledhje.

Këtu në këtë vepër tema del e përqendruar vetëm në nënfushën e mbretërisë së ngushtë të dashurisë së ashtuquajtur dashuri fiziko-biologjike (instiktive-ndjenjore) si dhe në atë psiko-sociale (ndjenjore-intuitive), ndërsa dashuria shpirtërore-hyjnore e ravijëzuar në kohë-hapësirë me vullnet e ndëgjegje të plotë preket paksa, por vetëm aq sa lë vend për të dëshiruar. Është fjala për dëshirat e larta ideale, intelektuale, njerëzore, ku bën pjesë edhe dashuria ndaj atdheut, ndaj idealit.

Sidoqoftë, çaste të këndshme dhe gjithë të mirat, lexues i nderuar!

Prishtinë, maj 2000

Autori

DY FJALË PËRPARA

Jam *babëmësuesi*, gjysh mahitar,
i kam fjalët hiç pa zarar
dhe me këto "bulëza shenjore"
përsh'ndes stinën tuaj rinore!

Nipçes, mbeskës me flokët çapraz
dua t'u sjell shqim buzët në gaz,
se në këtë stinë, ku sapo shkelin
veç me gaz mund ta shpojnë telin!

-Pse, -do të thoni,- vështirësi paska
dhe kjo stinë n'zemër të plaska!?

-Jo, po jetës, si thonë jetë
pa pasë poshtë e të përjetë;
por me mësim, them, me shumë punë
më lehtë shporren: brengë e dhunë!

Këtu, në këto vargje, lexuesi im,
pak janë rastet për sëmbim...
pra, vetë ruaju, të mos pësosh ves
si rëndesë gjumi për mëngjes!

Janë do vargje dalë razië
si do hope ngjyrë dashnie,
tejkaloji, lexo, buzëqesh
se do punë, dot, s'merren vesh,

ngase vij në pa pritë, pa bujë
dhe i takojnë veç moshës suaj!

VJERSHËTARIT TË RI

-Poet, vëlla i vogël, t'provojmë dhe gazmore,
me gaz e hare të mpleksura prore!

Ato mund të të sjellin në çast buzët në gaz,
por që mos t'i mbetesh hapit të kohës pas,

përpiqu, kryej detyrat, mëso dhe më shumë,
se mësimi, siç dihet, për t'rinj është kryepunë.

Fazat lehtë kalohen, kur kult e bën punën;
çka mund të kryesh t'premtën mos e lër për të shtunën!

-Mjaft me të tilla këshilla, o i miri Babamësues,
kësofarë mallrash t'lira s'di më a i blen kush?!

-Çfarëdo që del në treg, thonë, pazari e ha,
edhe "malli i lirë" myshtëritë i ka,

prandaj, ti përpiqu, or vëlla, të garosh,
se në luftën e vlerave, mund dhe të fitosh!

Dikujt s'ia mba xhepi, dikujt s'ia mba dija
dikush ka pengesa nga ligji, "qeveria"!

por gojën dhe shkrimin veç varri e pengon
sa të jetë gjallë krijuesi me vend e mend vepron!

Shpirti i bardhë, or vëlla, s'do pranga dashurie
ai do liri të shprehjes dhe në fushë poezie!

BULËZAT E PËRSHENJURA

-Babamësues, or babagjysh,
a thua se bota u përmbys
kur e sheh lulen e tharë
nga e tret era nëpër barë?!

-Jo, mor bir, përmbysje s'shoh,
jetë e shpirt lules ia njoh;
ajo dhe tash ndjen lehtësim
kur farë e erë le trashëgim;
çdo stinë jete ka hijeshi
që kur lind der' n'nd'rrim të ri!

-Po në botë t'kujtimit çka më parë
duhet dalluar, o gjysh i mbarë?!

-Në botë t'kënaqësisë dhe të jetës lule
"bulëzat shenjore" do parë pekule,
e në jetë të njeriut, mor i uruar:
"bulëzat rinore" n'dashni praruar!

MIRËMËNGJESI !

Mirëmëngjesi çupëz-vashë,
në këtë ag të zgjimësisë;
mirëmëngjesi çun-djalosh,
në këtë zgjim të djalësisë!
Mirëmëngjesi dhe përgëzime,
për këta hapa tuaj të parë,
si për shije, për buzëqeshje,
për gufimin tuaj fatbardhë!

Mirëmëngjesi, jetë e re
që në ag zë fill, del;
mirëmëngjesi drojë-guxim
që me moshën gonxhet çel!

PYETJE E RËNDË

Shfleton goca ca revista,
-Çfarë lexove - e pyeti gjyshja.

-Po, moj gjyshe, po lexoj,
po janë dy fjalë që s'po i kuptoj:

adoleshenti, puberteti(!) -
çfarë lidhjesh kanë ndërveti?!

-Eu, s'di mirë, mos qoftë me marre!
-Trego, gjyshe, nuk ke qarje!

-Poubertet a s' po bërtet,
adoleshenjt a s'dole i shenjtë(!)
s'di, veç Zoti na i ruajtë mendt!

Gjyshit gazi i shkoi te veshi,
Babit fjalët iu zunë ndërveti!...

Mami gocën e ftoi pranë:
-Këto dy fjalë, marre nuk janë.
Pak me kohë, pak me punë
do t'i mësosh më mirë se unë.

Më mirë të flasim në katër sy,
çka di mami t'shpjegon ty!

"LULET MUJORE"

Goca skuqet ka shqetësim,
mami qeshet, jep sqarim:
-S'është sëmundje, janë *silule*
stina e moshes i çon pekule;

Këtyre u thonë "lule mujore"
shenjë amësie, në rrugë nusnore;
dy-tri ditë, pastaj kanë të ikur,
t' kthehet nuri i çiknisë së rritur.

Kështu natyra na heq të keqtë
për amësi na bën të ndrehtë;
pas kësaj bukuria t'shtohet
dhe dashnia zë të kuptohet!

ÇUNI BURROSH

Shoh një çun që qesh me veten,
s'na thotë psehen, të vërtetën,
por kuptojmë nga sjellja e tij
se pati n'sprovë një fshehtësi!

Sot burrosh veten e ndjen
me sy tjetër vashat vëren...
s'do me shoqet, n'klasë që i ka
as t'flasë mbarë, as t'bëjë shaka!

Vallë, me cilën ka ndërmend
seriozisht me hapë kuvend?!

DHE KËTO GOCAT

Dhe këto gocat, tash si vasha,
pse *çuçu-të* po i bëjnë më të trasha?
Kur *çuçullojnë*, ndashtë, pse vështrojnë
po pse me gaz fjalët i shoqërojnë?!

Vallë, çka thonë me *çuçuçu-të*,
mos duan djemve t'ua luajnë trutë,
a mos duan t'ua plasën barkun,
apo duan t'ua shtojnë merakun?!

DHE KËTA ÇUNAT

Pse këta çunat tash burrosha
do sjellje i bëjnë t'pa shëndosha,
pse, vallë, ikin lënë shoqërimin
e nga gocat s'ndajnë shikimin?

Vallë, çfarë planesh ata thurin:
të fshehin dorën, të hedhin gurin!?

VALLË, SI QUHET?...

Vallë, si quhet
ndjeshmëria
që të rrëmbyeka
brendë gjithkah;

vallë, si të quhet
lumturia
që të ngërthyeka
e s'dilka në pah;

Vallë, mos është kështu
dashuria
që në frymëzim
të dhënka krah?!

GAZDASHNIA...

Ç'është diçka
që pikë nga qielli,
ç'është diçka
që ngroh si dielli?

Ç'është një afsh
për shpirtra të vvarë,
ujë - njomëtim
i tokës së tharë?!

Ç'është ai fat
që gëzon çdo të ri,
është dhunti
a gazdashni?!

DEHJE MAGJIKE

Dashuria, dashuri,
ka pushtet, thonë, ka fuqi;

si përbindshe t`gllabëron
me magji të mban, t`pushton!

Është çudi se kjo magji,
iu vardiset djemve të rinj

dhe askush nga kjo s`mund t`ruhet
ditirambi për të thuret...

Thonë, kush dehet në pije të saj
i përzien gjithë gaz e vaj!

FJALË GOCE!...

Është një gocë, një shoqe e mirë,
shumë e gjallë, por n'fjalë e lirë;

një ditë shoqeve në tubë u tha:
-Kam vendosur diç, pa shaka:

kur të shkojmë sot në diskotekë
s'do t'i flas "çunit": sa me dekë;

S'do të loz me të as dans as rok,
s'kemi gjë, fundja, e shoh si "shok";

se jam e fjalës me qind për qind
eni me mua se do t'ju bind.

...Por, sa ish me shoqe pa hy në sallë
ngjau, çfarë ngjau: "skandal" i rrallë:

goca djaloshit ngrykas iu hodh
për fjalë e shoqe, fort nuk u lodh!

Por edhe shoqet e vështruan me gaz:
çfarë bëri goca me fjalët çapraz!

SHOKU I PASHOK!

Thuaj çfarë shoku na je ti,
kur me gocën ikën rri,

shkele kështu besën-fjalë:
-S`ndahem - thoshe - për të gjallë!

E tash një gocë, një minifunde
ka filluar me të ngrehë për hunde!

Madje zhytesh dhe më thellë,
keq për shokë ke nisë me vjellë:

gjoja ne s'kuptuakemi fare
se n'stinë të re do hyrë pa qarje!

Dhe një herë vërejtje të tërhiqet
kthehu, mos lë vesi të piqet;
hiqju gocës o i pashok
mos harro fjalët që lidhëm tok!

QENË PESË GOCA...

Qenë pesë goca, gishta dore,
të pandara, shumë gaztore:

Dona, Imja - prinin në mësim
Vala, Bardha - në këngëtim
ndërsa Besa që syze mbante
nxiste shoqet të bëjnë *debate*

për çdo çështje... dhe për detyra
kjo dallohej si më e mira.
Po një ditë, ky farë shoqërimi
pësoi një rënie rrokullimi:

Në një *disko*, i nxënë kokat
pikë e pesë na u bënë gocat:
njëra: "ikim"!, tjetra: "rrimë"!,
njëra: "lozim"!, tjetra: pimë(!),
ndërsa e pesta, s'dukej fare
me një djalë fshehej në bare!

E tash shoqet më rrallë shihen,
n'sy të të huajve bëjnë se s'njihen!

TELEPATIKJA

-Shoqe moj, a më dëgjon,
është një punë që më rëndon:
me djalushin dalim *njëzë*
e vërtetë, s'është gjë-gjëzë!

Dhe kur s'jemi pranë e pranë
dhe kur ikim në tjera anë
krejt e di, çfarë bën ai
çfarë bëj unë ai krejt e di!

Po, po e di krejt çfarë bëj unë
qofsha zgjuar, qofsha në gjumë!
Dhe unë tash di krejt për të
kur të jetë zgjuar dhe kur fle!...

A e di ti, ç'është kjo dhunti,
a i thonë kësaj telepati?!
-Po, e di, moj e uruar,
në dashuri pasket kafshuar!

KUJDES, BIJO!...

Bijo, moj, eja të mëson lokja
ke kujdes mos të rrejë koka;

ikju "lojnavë", me shokë, me djem
se po të ndodhë, çka s'mund ta them!

Me lojë, bijo, lind dashnia
me lojë, besa, të zë magjia!
ndodh me ra një pakujdesi
me u ndezë shpi e katandi;

me të humbë shkolla në rini
e kryen kryet pastaj n'pleq'ri!

AH, QERPIKU!...

Sytë: falë zotit
vetullat: grep,
po qerpiku:
merr e jep!...

Deshi ta bëjë
rremba - rremba
po një fiye
iu fut brenda!

i skuqi pak
t'bardhët e kokrrës
po këtë faj
ia hodhi shoqes:

-Shoqe, moj
xhelozkëfryra,
pse më sillesh
nga pasqyra!

Thua, m'ke shoqe:
me u përbe
e për *grim*
s'më ndih si dje?!

...Ranë këto fjalë
dhe shoqja iku;
shkak-pasojë:
fajtor qerpiku!

ZËNKA

Shoqe, ndal, ta them një fjalë
për një zënkë me atë djalë:

çka do të vesh ai m`i vëren
dhe të gjitha m`i pëlqen,

por nga flokët më quan arushë
që rri malit e s`del për fushë!

më thotë, preji flokët, ballin lëshoje
një vesh, qafën pak zbuloje!

Si t`ia bëj, çfarë më thua,
reng i madh është ky për mua!

Ai s`merr vesh, se nga "pështyn" pula,
e m'ngatërrohet nga frizura!

A t`i jap urdhër me "myhyr"
më flokët e mia: mos me i këqyrë!?

DY SHOQE TË PANDARA

Janë dy shoqe: Besa, Shpresa,
s`i ndan mosha, s`i ndan vesha,

s`i ndan shkolla, s`i ndan rruga,
s`i ndan gjumi, s`i ndan buka!

Por një ditë në një shëtitje
kah ai pylli me ahishte:

u ndanë shoqet, shkak rreziku
që kanosej, mor lum miku!

se n`pyll, dihet, ka shumë lisa,
çuba, "cuba", mbase bisha!

andaj, kërkuan, për "sigurim"
t`i shoqërojë veç nga një trim!

Dhe kështu Besa gjeti Cimin,
kurse Shpresa zgjodhi Gimin...
Vallë, dy shoqet e pandara
a do të rrinë bashkë si përpara?!

E DI...

Nëna më thotë:

-Ruaju bijë;

babi më thotë:

-Ke mendjen ti!

Gjyshja vëren:

-Mos na korit!,

vëllai, më i madhi:

-Shih, hapi sytë!

Vallë, pse e bëjnë

kaq të madhe punë:

"kërshërinë"

qe e di dhe unë!

S`jam e vockël,

as aq "fushë",

të gjashtëmbëdhjetat

tash po i mbush!

E di zjarrin

s`duhet kapur,

e di varra

s`duhet hapur,

por diçka

kur vlon në gji

duhet shuar

dhe këtë e di!...

PËR RINJOHJE!

Ku ta gjej a gjendet dot,
vallë ndër yje mos yjon,
ku ta vërej a vërehet dot,
vallë ndër pyje mos pyllon,
mos ndër fusha, ndër lulishte,
mos ndër gurra rrezë ahishte?...

Ku ta gjej a gjendet dot
a mos lodhem, kërkoj kot;
as në ëndërr tash s`më shfaqet
engjëllusha e qiellit s`kapet!?
-Eja në vete, - më flet një zë, -
ndal për tokë mos ik mbi re,
vajza e bukur meskëputur
veç në zhgjandërr të është futur,
me të u rritet me pekule
loznit bashkë, ujitnit lule!..,

Fqinjen tonë me shpi përballë,
s`e rinjihke, ende, vallë?

KURORA E PËRJETËSISË

Kurora e buzëqeshjes
ka të madh pushtet
kur nga thelli, shpirti
uron: jetë, shëndet,

por froni i mbretërisë
që jep shënjtëri
është, them, pa drojë:
buzëqeshja pa djallëzi,

por buzëqeshje të tillë:
me ngjyrë vashërie,
të ëmbël, të pastër
me rreze përjetësie

gjen veç në ato raste
kur lind poezia,
vetëm në ato çaste
kur bulëzon dashnia!

FRYTI I BEKUAR

Rrënjë në qiell,
rrënjë në tokë;
gjethe, lule
fryt në kokë;

fryt i pastër,
fryt i shenjtë,
fryt dashnie
jetë e denjtë;

qielli, toka
s'bëjnë mëni:
vasha, djali
plot magji;
fryti i pemës
së arrirë
stolis t'ardhmen
dhe më mirë:

të ardhme të dli­rë
me trashëgim,
lunturi
deri në amshim!

BISEDE ME GJYSHIN

-Gjysh, shpesh më thua, pse me ty s'flas për punë të mëdha, para se të shklas.

-Nipash, folë, mor tungjatjeta, a s'po të ujdís motoçikleta?!

-Qysh po e di, o gjyshi i mirë?

-Unë di ç'bëjnë dhe yjtë në qiell!

-Si të bëjmë, gjysh: kombi-veturë, karavan të ngohtë si furrë!

- Po pse e do qerren karavan me dyshek e me jorgan?!

-Ndryshe s'di, gjysh, si të martohem të arrij si ti dhe të trashëgohem?!

-Është pak herët, he, të gjettë e mira, mos ia çel kujt këto dëshira, se do të qeshin hingirizen edhe ata që ta duan të miren!

Këto lehtë bëhen sa të kryhet shkolla: kur t'hysh në punë e të bëjsh të holla!

-Heu, babëgjysh, kodër pas kodre, vështirë të kryhet kjo farë shkollë?!

Më mirë tash me këqyrë për nuse se druaj po mbetem: peshk ndër puse!?

-Për çdo vend lypet një send, për çdo send lypet një vend, po çdo kohë ka të vetat ligje me një hop s'kalohen brigje!

PORTRETI I PËLQYER

Ka rreptësi në punë,
i lirë është në shoqëri;
flokët mban mënjanë
si shumë shokë të tij;

me sytë hark-shigjetë,
vështron rrebtë me ngulm;
mban qendrim krenar,
i gatshëm, t`hidhet në sulm;

lustër të rreme s`do,
s`pret shpjegim nga bebëzat,
si djalosh i pjekur,
vetë në jetë i thur vegjëzat:

vegjëzat e buzëqeshjes,
vegjëzat e bontonit.
ngjyrën e lëvizjes
ritmin e aksionit!

Kështu më hyri befas
në timen t`brendshmen botë
ja, kështu, unë e dua,
kështu xhani ma thotë.

Po tash si t`ia shfaq
shpirtin tim: bardhësi
që dhe ai ta kuptojë
çka ndjej n`brendësi!?

ÇFARË DO ?!

-A do djalë
pite kulaçe?
-Jo, të këqyr veç
pikat në faqe.

-A do djalë
simit, xhevrek?!
-Jo, t`vërej sumbullat
në jelek.

-A do djalë,
syret me të falë?!
-Jo syret,
po një pulëbardhë!
-Çfarë do djalë,
ç'kërkon prej meje?!
-Fare hiç,
t'jem afër teje!

-Oii, oii
obobo!
kush di djali
çka po do!?

DRIDHËRIMË E AFSHTË

Një e lehtë dridhërimë
shtatin ta kaplon,
një e ëmbël melodi
lehtë-lehtë të pushton;

një e artë buzëqeshje
të endet trupit, n`fytyrë
hare e prarueshme
në thellësi të ka hyrë!

Tash kërkon të dalë,
tash kërkon të shfaqet,
tash kërkon frymëzimin
që shpirti të kënaqet!

Dridhërima e lehtë
buzëqeshja e afshtë
në melodinë e ëmbël
t'shkrihen qetas rrafshhtë!

NËN AFSH

Sa ma kënda
ta vështroj
sythin e lules
gonxhe në shpërthim!

Sa ma kënda
të hedh vështrimin
në zbardhëlimin
e ditës në agim!

Sa më josh
gjethi
që lulen e pjeshkës
shoqëron!
Sa më ngjeth
përjetësia
që rritet n`ty
dhe t`gjallëron!

SOLLI ERA...

Solli era prej lartësie
një frymëzim të rrallë,
dhe frymëzimi: ngjyrë risie
çast të lumë, fatbardhë!

Solli djali larg nga fusha:
lule plotë aromë...
dhuroi vasha, sylarusha:
buzëputhje të njomë!

Të re shprehje era solli
gaz me lumturi
zemra-zemrës himn përcolli
n`vargje poezi!...

ATËHERË...

Atëherë,
kur të bulojë kopshti i dëshirave
dhe bilibili t`ia thotë me ëndje;

atëherë,
kur të qeshë agsholi luledehës
dhe do të zgjojë dëshirën në zemrën tënde,

atëherë, po atëherë,
ne, do të ndeshim çaste lumtësie
dhe do të thurim kurorë përjetësie!...

FJALË PA BISHT!...

M'u ngjeth shtati,
m'u dridh dora,
nga gjoksbardha
më shkiti molla!...

më shkiti molla
në dorë të ra,
-Djalosh, të lutem:
mos e nga!
-Nuk e ngas,
as nuk ta kthej,
me një dardhë
mund ta këmbej?

-Jo, se dardha,
thonë, ka bisht,
bishti druaj
më ther në gisht!

-Gishtin, vashë,
ta mbron unaza
nga fërf'llaza,
dhe bishtdardha!...

ÇAST...

Një idilë plot me gëzim:
vashë e djalë në përqafim.

Dashuria josh rrëmbën
shoqishoqin kur pëlqen...

Në këto çaste të bardhës jetë
syri, zemra flasin vetë...

vetë qesh fytyra, men andralla
s`dridhet buza, s`lot qepalla!

ÇFARË NDODHI?!

Zë një punë,
tjetrën kap,
pa arsye
te tjetra vrap,

për qëndisje
lyp pëlhurë,
plastelino
për pikturë!

Lyp gjithçka
dhe çka s`të vyen,
nis shumë punë
asnjë s`e kryen,

nganjëherë
libër, fletore
veç sa i merr
i hedh prej dore!

shikon veshjen
çast e çast
të duket vetja
zemërplast!

Ç`ke, me nënën,
troç ma thua j,
ç`të ka ndodhur
folë, mos druaj!

Më thua j, çfarë ëndrre,
trazim të solli?!
Mos, vallë, n`gjumë
bolla t`mbështolli!?

KITARISTI

I shoqërueshëm është një djalë
loz shumë bukur me kitarë:

popullore e zbavitëse
serioze e pak mahitëse

sipas vendit i lancon
dhe tërë grupi e shoqëron,

por një ditë ngjau befasi,
derisa e ndiqnin vesh e sy:

solistin zëri na e "tradhtoi",
"variacioni" i "inkarnoi",

po ky sa pa: ç`ia gjeti zërin,
këngës fare s`ia preu për in,

po u dha telave më shumë "gaz",
nga tenori doli në bas!

Të gjithë qeshën, s`u këput kënga,
tash diç djali, ndjeu nga brenda!?

TRAZIM I KËNDSHËM

Shoh njëfarë kuqlimi,
vashë, si të ka kapluar,
me njëfarë trazimi
të këndshëm: praruar?

Ç`është kjo mrekulli,
ç`është kjo stoli jete,
kuqlimi, hijeshi
aureolë në vetvete!

Kush ta zgjoi nga thelli
këtë kurorë risie,
mos çapkën gaxheli
me dhelka çapkënie?!

PËRSHËNDETJE

Zemërsisht
përshëndes lulen e sapoçelur
se në aromën e saj
shoh një pjesë të jetës hare,

butësisht
përshëndes bulimin e shkrepur
në sytë e të dashuruares
kah troket lehtë
në dyert e botës së re,

ëmbëlsisht
përshëndes rrezet e diellit në agim
se në të përkunden magjepsisht
ëndrat djaloshare,

vargërisht
përshëndes shprehjet plot dritë-njomësim
me buzëqeshje risie praruar
në prehërin behar të jetës lajmëtare.

MË THUAJ?

Më thuaj a flet goja
kur flet syri,
zjarrit të zemrës
a i del tymi?!

Trazimi i këndshëm
a është frymëzim,
a i lypset fjala
fytyrës plot kuqlim?!

Thuaj pse dridhet buza,
thuaj pse puthet gusha
ndjenja dashuri
a është e hollë si fluska?!

Pse s`lirohet goja,
kur mund të flasë syri,
pse kur qëllon zjarri
zemrës s`i del tymi?!

LAPSA GRIMIMI!

-Babi, të thashë, para më jep,
të blej ca lapsa që i di vetë!

-Ç'janë, bijo, gjithë këta *kalema*
garniturën dje ta bleva,
me penel, lapsa specialë
dje i kam prurë, për ideal!

-Babi po, po duhen të tjerë,
vetë dua mamit me ia blerë:
një si të kuq për buzë karmin,
një për hije ngjyrë kinin,
një mavi, një për qerpikë
një për faqe me vu pikë!?

Besa edhe llak për thonj
dhe për flokë ngjyrë karaboj!

-Thuaj më drejt, t'u dashtkan ty,

mamin këtu mos e përzi!...
për këtë *t'ri art*, shpreh përgëzime,
por kujdes, bijo, dhe n'mësim!
- Babi, ta blej dhe pak varak,
sa për mësim mos ke merak;
shkolla, thonë, është lumë me valë
gurgullimën kurrë s'e ndalë,
andaj ne kohën shfrytëzojmë
shijojmë jetën edhe mësojmë!

VAJZË FLAMURJA!

-Është një gocë emrin: Flamure
kuq e zi pror' mban kostume;
n' xhep t'jelekt, për mbi zemër
e ka vënë të njëjtin emër,
ku shihet qartë fjala: *FLAMURE*
me do shkronja stil pikturë!

Po kjo gocë, o lum si ti,
ka mirësjellje, me folë di;
di të këndoje këngë flamurore
dhe mban pamje shqim madhështore!

Gjithçka në dukje i ka hije
kësaj Flamur'je, ngjeshë lavdie!
Mos me zgjatë është e hatashme
edhe e mirë, edhe e pashme!
Ka buzëqeshjen si magji
me kënaqë zemër me kënaqë sy!

-Mos fol më, o shpirt i qeshur,
ylber dashnie të paska veshur!
do të pyes gocën *Kuqëzi*
vallë, çfarë ndjen ajo për ty?!

"MARRELIA" I LYER ME VAJ!

Jam i gjallë, thonë, jam i zgjuar,
ndoshta për mua ke dëgjuar,
në vallëzim dje dola i pari,
në lojë-letrash më ecën "zari",

për film-albume kam "respekt",
lexoj etshëm çdo "prospekt";
kam durim e guxim prore
shpesh në zënka korr fitore,

në kafene, në rrugë, në shkollë
tym duhanin e çoj fjollë;
sa për mësim e sa për nota,
nuk ia var se çka thotë bota,

babë as prof, unë kurrë nuk lus,
porse klasat në xhep i fus...
Jam i fortë, në duar, në këmbë,
arrat mund t'i thyej me dhëmbë;
më thonë: "i lyrë n' uthull e vaj"
përvojë madh jam, mos më qaj?!...
Veç për "loçka", s`gënjej fare":
nuk po më ecën, po ndiej marre?!

...Kështu i ankohej një vajzushe
që sa i kish nxjerrë "këmbët" për fushe!
Zogzë-naivja, kokë-mendjeshkurrë
a do t'i shkojë dhelpnakut në zgurë!?

Ndoshta po, mik, a mbase jo,
po sa vlen, vallë, të dihet kjo?!

"MËSIMI" NË NATYRË

Djali me ca libra,
vështron rrah`n mbi barë
që para tij "vajzushja"
po e hap me ngadalë...

-Dale djalo, të lutem,
lulet mos t`i shkelim,
mos t`i trembim bletët
mjaltin kah e mbledhin?

-Bletët le të ikin,
le të shkojnë në tjera anë,
le të përgjunjen lulet
kur të kem ty pranë!

Lulet, bari, fletat...
le të mbeten kujtim,
"leksioni" i mësuar,
mos të ketë harrim!

MOJ FLOKËKREHURA!

Moj flokëkrehura dredha-dredha,
s`di a më ftove që pas të erdha?
pas të erdha moj kaçurrele
dhe s`di pse ti gojë nuk çele?

hë, pra folë, moj dredharushë,
moj thekëdhura deri në gushë,
se unë fundja pas të erdha
jo aq për flokët dredha -dredha,

sa për hirin që fshihet në ty
për joshësinë që ndez me sy!
Moj flokëkrehura dredha-dredha
a s` gabova që pas të erdha?!

PËR LESH RAT NË ERË...

Kur era të përkdheli faqet
desha të jem puhi;
kur era t`i shprishi leshrat
desha të jem stuhi;

kur era e solli shiun
dhe filloi të bjerë pikë-pikë,
desha të bëhem mjegull
të të mbështjellë një çikë;

kur era largoi retë,
ylber desha të jem
që në bukurinë tënde
paksa ngjyrë të kem;

kur era dhe rrezet
në fresk të gudulisen,
atbotë desha dhe unë
aty ta kem hisen;

dua të kem hise
dhe te leshrat në erë,
krah fytyrës sate rreze
që të ndrin përherë!

BUZËQESHJE E MAGJEPSUR

Buzëqeshjen ia fale ylberit,
tani ai në ballin tënd shkrep,
i buzëqeshe hënës,
ajo bojargjendi të jep,

i buzëqeshe pranverës,
ajo beharin ta fali ty,
i buzëqeshe jetës,
ajo tani të bulëzon në gji!

Lulbehare, lulëshëngjergje,
falma dhe mua pak buzëqeshje
që të kem ylber dëshirë,
rrezehëne dhe më mirë
që të mbrumem në dashuri
të gëzojmë jetën tok të dy!

STOLI MBI STOLI

Shoh një vashë gjifryre,
në lulishten karshi,
këput një trëndafile,
stoli mbi stoli!

Vallë, ç'i duhet lulja
në jelek kuq - mavi
aty në mes të gjinjve
stoli mbi stoli!

Shihet kah merr frymë:
gjoksi çohet kthen
stoli mbi stoli
këtë kush s`e vëren?!

Lulja, mosha, vesha
vasha shëndet plot
stoli mbi stoli,
syri, s'duron dot?!

Më thua, moj vashë gjifryre
me trëndafil mbi gj
kush ma shpague mundin
që po vuaj për ty?!

SIXHELOZKA

-Djalosh, mos këqyr në të huajin terren
malli fals gjithmonë zhgënjën!
Shoqërisht, kështu, ta bëj me dije
as s'të bjen mirë as nuk t'ka hije;

mëkat me i rrejtë sytë me mallë të huaj
tue i pase të gjitha në konakun tuaj;
s'e kam për vete sa e kam për të dy:
unë në dorë kam veten po rroj për ty!

-Faleminderit, për gjithë këtë kujdes,
por ruaju, mos të të kalojë n'ves!
a s'të bën me qeshë jeta e përgaztë:
syri plot s'ngop barkun zbrazët?!...

-Djathi i mpiksuar s'mbetet droçkë!
-Vetëm ty të kem shpirt e loçkë!

NDJENJARTA

Në takim djali e vajza
shkon rrënqethja valëza-valëza,
aty lindi ndjenjarta,

ndjenjë e hollë, shumë e hollë
që ua bën faqet kuq si mollë
që vetë stina u dha kurorë...

fërgëllin kjo lehtë e lehtë
iu hyn në zemër e nuk i vret
sepse mosha e thuri vetë...

vallë, a dinë, tash, vajzë e djalë
që guguçin e s`bëjnë fjalë
çka ndjenjarta u ka falë!?!...

PSE?

Pse po i quani të hutuar,
pse po i quani të ndryshuar
çiftin e ri shpirtbardhë!

pse atyre ndryshe u dukka
se vetë bota n`thes u futka
e ata mbetkan si më parë!

pse po thoni: çudshëm flasin
dhe po thoni kot gëgasin
veç pse dashkan më shumë liri?!

mos i vëreni n'se bëjnë çalime
qoftë në sjellje, qoftë në mësim
dhe se nuk shprehkan shumë urti!

Mos harroni, janë n'atë fazë-moshë
kur mund të marrin kthim të shëndoshë
dhe të ndryshohen shumë më mirë,

Andaj për ta mos të përflitet
pse e ardhmja në ta zë rritet
dhe se dashkan të jenë më të lirë!?!

Pra kur të gjykoni, o të moshuar,
kurr mos i matni ata "të gëzuar"
pa peshojë të kohës së vet!

Gjithë për të riun kohë do të ketë
të përmirësojë ndonjë të metë
e për t'vjetrin jo, o haj medet!

NË TAKIM

Dora shtrëngon dorën, ngjatjetojnë pa fjalë,
ngase me shikime njiheshin që më parë?

Mbërthyer trazimesh, në çaste që i vërshuan,
fjalët e gatitura disi i harruan...

Vajza e theu akullin: -Reja e zezë majmali!
Djali toku dorën: -Shiu s`mund të na lagi!

Sa çudi me të dy me orë ëndërruan
e në këtë çast të lumë disi u hutuan!

Po kjo fazë fatale zgjati veç ca dakika,
u ikën shpejt trazimet u iku shpejt dhe frika.

Vajza këqyr natyrën: pikturë ideale
djali e sheh vajzën një perri ndër male!

MAGJEPSIA

Djali në vallëzim
fluturon me lehtësim
tam-tamin e ndjen
dhe diç e rrëmben...

me të dirsur mustaqja
me të lëkuqur faqja
zemra i lyp ahëng
djersën e lë peng!

Askë s`e gënjen
çdo vajzë e pëlqen
shikuar n`çdo "aspekt"
për to ka respekt!

por sonte diç i ndodhi
në zemër copë i hoqi!...
... një vashë engjëllushë
kish të bardhën gushë!

mu si njalë rrëshqiste
të gjithë i mahniste
dhe i shtonte "oreks"
me ata sytë "magjeps"!

po, vallë, ky farë fati
emrin si e pati,
që tash djalit të ri
parasysh po i rri?!

NË MES TË ORËVE

Në mes të orëve, në klasë brenda
keqandjali të ngacmoi:
një blë flokësh t`i përkëdheli
ashtu sëkithi nga kaloi ...

Ti në heshtje e kalove,
bëre gjoja, s`pa asgjë,
ndërsa shoqes për bri teje,
i buzëqeshe, s`di se pse?!

Në pushim tjetër goxha keqi
të ngau prap, me klok në gisht,
ti prap heshte, "incidenti"
aq i rëndë, t`u duk, nuk isht'!...

Të tretën herë po ai "keqani"
që të shikonte flakë i skuqur,
pak me këmbë në ty zateti,
t`u bë gjaks, ashtu në të dukur!

Në ato qaste profesori
papandehur u pa në derë,
ti e fryrë, me sedër të fyer
"alarmove" menjëherë.

Rezultati: sy - kokë ulur,
dinjiteti, për një pare:
në ditar pikën as qortimin
duket "keqa" s`i ndjeu fare!

-Pse padita,- u pendua vajza,-
pse u nguta, ta hajë djalli,
sa i mirë qenka ky "keqani",
i qeshka buza, i ndritka balli!

NË MBRËMJËVALLËZIM

Çka ndjeve vajzushe,
pse buzëqesh "vogëlushe",
vallë, gaz pse u mbushe
m'thuaj çfarë ndjeve në gji?!

Flokët pse t`u shprishen,
sytë pse t`u dalldisen
e faqet kuq të shndriten
prej nga gjith kjo magji?!

Mos në këtë çast
të është dhënë rast
që të nxjerrësh jashtë
më të shtrenjtën ndjesi?!

Më thuaj lum ti çika,
si të iku frika,
si të dha krah muzika
e të hodhi në fluturim?!

dhe si të shkrep balli
në krahët e atij djali
që pat fat i pari
me t`marrë në përkëdhelim?!

Tani në krah të "amorit"
që të dytë u hodhët,
mos, vallë, njëri tjetrit,
zhgjëndrrat ia vodhët?!

ÇAST HUMBËTIE

Vasha këqyr pak anash,
vjedh me sy ngapak
lëviz gishtat, grushtet
rrezik s`ndjen aspak;

syri gozhdë i djalit
thuase e përpin,
por papritur rrezja
i dha tjetër drejtim;

vajza mor guximin
vështroi më me ngulm,
djali ndërroi qëndrimin
i prekur thellë në zulm!

Ç`është kjo, çfarë po ndodh,
mosmarrëveshje vallë,
jo, rrënqethje afshi
rrëmbyen vashë e djalë,

po nganjëherë humbin
në "vakuum" të gjithësisë,
por prap në çaste kthehen
në ekstazë të "dashnisë"!

DIALOG

-A je ti Brizhitka,
a je yll i ri,
që për filmin tonë
u gatitke ti?!

-Jo nuk jam Be-Be-ja
me "seks-bombë", reklamë,
por jam vetë hareja
që gjezdis në këto anë!

-Mos je ti vajzushja
që n`ëndër më përfton,
mos je ti zanushja
që lumturinë ma shton?!

-S`jam yll, as zanushe
ti këtë mirë po e sheh,
por jam fatmirushja
pse bëhesh se s`më njeh!

-Frizura "brishitkë"
më mahniti shumë;
-Ti njihke frizurën,
po cila qenkam unë?!

-Më fal aktresha ime
me frizurë të re,
eja një çikë më afër
të të them se cila je?!

PËRHITJE NË KALIM!

Si t`ia them, si t`ia shpreh,
unë e shoh ai nuk më sheh;
si t`ia shpreh, si t`ia tregoj,
më përpalli, më përshekoi;

më pëshkoi me heshta afshi,
si t`ia shpreh, si t`ia them,
zemrën s`i kam prej mëndafshi,
as t'fortë guri, s`dua ta kem!?

Si t`ia bëj, si t`ia shpreh
unë e njoh, ai nuk më njeh;
nuk më njeh, andaj s`më qas,
si t`ia shpreh, a t'i shkoj pas?...

Pas t`i vete, t`i them çdo gjë:
për atë çast, për atë vëgim;
vallë, ç`ti them, s`paska asgjë,
veç përhitjes në kalim?!

DHURATË NDJESIE

Kur erëmon lulja
ngazëllen bukuria,
josh vetë natyra
dashuria ndrit...

kur këputet lehtë
lulja hareveshur
në dorë të dashurisë
dhurata mahnit!

kur t`barten ndjesitë
nga zemra në zemër
lulja ndjen në vete
lumturinë në kulm!

pasi të flaket jashtë,
pas ndjesisë dhuratë,
lulja për në amshim
do të kthehet me zulm!

PUSHI E PRUSHI MAGJIK!

-Me pushë në sy,
me prush në gji,
ku je nisë
djalush, or ti?

-Mos më pyet,
ku e kam kryet
se këtë punë
as vetë s'e di!

Ku të prekka
gaca djegka,
push e prush
magji të bëka!...

Për një gocë,
për një kocë
prushi, pushi
më la pa kokë!

-Eja në vete,
or djalush,
se dhe ty
të njihka dikush:

pushi, prushi
mrekulli,
ta kthyen të parën
dashuri!

MENDJELEHTA

Mendjelehta
hundpërpërpjeta!

Ngridhalaqja
mezi ec,
si pahiri
me sy "mbrec";

cullakohet
deri në gjoks,
me ca meshkuj
luan "xhou-boks";

imiton
artiste mëkati,
"ngarkohet"
përtej takati;

pi duhan,
pi raki,
ngapak drogë
sa për "mahi"!...

Kështu po zhytet
rrukullim,
në të palarat,
në rrugë pakthim;

hundëpërpejta,
mendjelehta!

SPROVA

-Sa nervoze,
tekanjoze
jam
veç unë e di,

prandaj ik
mos m`u pik
se mund
të pësosh dhe ti!

-Kështu të dua,
je për mua
dhe unë
më i mirë s`jam,

nuk largohem
dua të pajtohem
me gjith mend e kam!

HARRAQI

Kur ndajnata vjen me të mira
kënaqet shpirti kah lëndina,

pushon truri, forca shtohet
kush ka fat me shokë t`argëtohet...
Por ndonjëherë ndodhin teprime
që për kokë bëhen morrnime,

kështu buzëbrëmje një djalush
futboll luajti me shokë në fushë,

jo pak kohë, por orë: tri-katër
duke harruar kështu plang e vatër,

plang e vatër, mësim, detyra
dhe pse n`shpi do të hajë bërtima,

por këto i falen me "autokritikë",
por çfarë t`i bëjë tjetrës "tzezëditë";

si t`ia bëjë një tjetrës punë
që është "bina" e madhe shumë:

loçkës i kish dhënë besë me fjalë
gjallë o deké në takim me i dalë;

kish caktuar vendin dhe orën
nga harresa ka humbë "forën",

Ndashtë, se e bart nofkën "harraq"
por do ta pësojë më shumë se aq...

fundja sedra s'bën të fyhet
veç njëherë kulaçi thyhet,

veç njëherë thyhet kulaçi
arsyetim si të gjejë harraqi!

PËRGJUMËSIM

Gjumi është djepi i ëndërrimeve
ushqimi i shtrenjtë i jetës shtalbore
nevojë e vegimit të dashurisë...

Gjumi është prehëri i pikëllimit
kur në jetën shtalbore zë e përfiket
shpresa e ardhmërisë...

Dashuria e parë trazohet në përgjumësim
dhe bashkë me trazim e gudulim përkund
dhe frytin e shpresave n`bulëzim!

TREJTJE DISPONIMI

Ç`ti plandosi shikimet vashë,
pse shikon ashtu për dhe,
pse nuk sillesh vërdallë-vërdallë,
ashtu siç të pashë dje?!

Pse tani s`flet pa kontroll,
jij e lirë, ç`të teket folë,
atë gëzim që dje ta pashë,
kush ta treti, e lumja vashë?!

Mos shiko me sy për dhe,
unë të dua siç të pashë dje,
folë lirshëm, pa farë kontrolli,
ç`pushtet zemrën ta pervodhi?!

QËNDRIM ENIGMATIK

Kur së pari të pashë
shikimin ma ktheve
dhe kur pas të rashë
më shumë më mallëngjeve

pastaj në të ndarë
buzëqeshje më dhe
dhe për ritakim të mbarë
"mirupafshim" më the!...

por sot sa t`u afrova
ti fare me gojë s`më fole,
por sa u largova
me lot më vështrove!

Më thua, çfarë po ngjet,
e çfarë ka ngjarë, pashë hirin,
vallë, këtij lëmshi "sekret"
a mund t`ia gjejë kush fillin?!

GONXHE, MOJ!

-Gonxhe moj, lule e paçelur
a të puq biskun me të përkëdhelur?

-Jo, moj mendje, pse po të ngutet
bisku i gonxhes s'bën të puqet,
pak me i prekë të njomin shtat
i pëson shëndeti, bëhet mëkat!

-Gonxhe e nguftë sa t'shoh me sy
mrekullisht më ngjeth lakmi!
S'duron shpirti, gonxhe moj,
bulëzat, dua me dorë t'i lëmoj!

-Jo, mor jo, bulat nuk preken
janë fort shtalb, druaj se meken,
vetëm lulja të këputur do
kur të çilet, o i mirë, djalo!

Kush pret lulen të këpusë në erшим
jetë - dashni do të ketë n'amshim!

DHURATË KËNGËTARI

Nën tingujt e kitarës
u lind e re kjo këngë
çast ky lumturie
që largon çdo brengë...

në tingujt e kitarës,
ti moj vashë qëndron,
dhuratën që më fale,
këngë a s'e dëgjon?!...

Krenaria jote
dhe natyre e qetë
në tingujt e kitarës
shprehen qetë e lehtë;

njomësia rinore
zhdërvjellësia në punë
në jonet e muzikës
ngrihen lartë, shumë...

Tek ti moj bashkëshoqe,
zonjë e fatit tënd
jehet e kitares
ikin zënë vend...

jehet e kitarës
shprehin përjetësi,
më buzëqesh bashkëshoqe
këngën ta fal ty!

IDILË BASHKËKOHORE

I thotë djali: -Vashë,
dysyditë t`i pashë,
ti pashë dhe t`i dua
a i ke ruajtë për mua?

-Për ty janë, or djalë,
por t`i çfarë po më falë?!

-Ta fal një fole,
që të ngrohë me hare,
dilmë përtej burimit
si zogza bilbilit?!

-Vetëm të dal, djalë,
druaj turpi më kallë,
prandaj jakë të vëmi,
bashkë më të sigurtë jemi!?

IDILË FSHATI

Djali ecën rrugës
si me hap ushtari,
kur hetoi të Mirën
aty prapa gardhi:

ishte ballëkrenare,
ishte vetullhollë,
lidhë bistek për shpine
faqe-gji frangjollë;

me të vjedhur e shpoi
me ata sy shigjetë,
po nuk jepet "burri"
nuk dorëzohet lehtë!

Deti kos le të bëhet
pushka le të kërcasë,
le të dalë ku të dalë
vendosi t`i flasë.

T`madhe ia tha vetes
që ta ndiejë "drenusha",
-A t`ia mësyjmë bashkë malit,
nëse punë s`bën fusha?!

Nëse nuk ia japin
mendon ta grabisë
do t`vë në rrezik jetën
për "robin e shpisë"!...

ËNDËRRIMI I KOSTARIT

Nën hije të lisit
djaloshi qe shtritur,
lulet kundërmonte
ngapak i dremitur...

në çast sytë iu mbyllën
për disa sekonda
në ëndër iu dëftua
në bef u ndryshua bota:

nga qielli diç e shenjtë
i erdh nën hije t`lisit
dhe i dha freski jetës,
afsh e lehtësi shpirtit!

Vërtet iu shtir ëndërr:
një sivashë perri
që lehtë e puthi n`faqe
dhe iku nalt në ajri!...

Vrik u zgjua djaloshi
e si iu tret zgabimi
jo larg hetoi vashën
kthehej nga burimi.

Ndërsa ëndrrën djali
ashtu ia tregonte
vasha skuqej skuqej
bënte s`e kuptonte!

Vallë, kush qe përria,
kush qe mrekullia
që ia mori të gjitha
dhe ëndrrat e tija?!

RREZJA NË DRITARE

-Gëzimin ta shoh në buzë
sa herë del në dritare,
moj vashë leshralëshuar,
moj fytyrë lozonjare,
mendja po ma thotë,
siç po merret vesh,
se ti del djaloshit
zemrën t`ia rrëmbesh!?

-Jo, unë dal për vete,
rrezet kur më ftojnë
që me ajr të pastër
flok't m`i ledhatojnë!

Çun, nga kjo dritare
asgjë nuk rrëmbej
pasi jam këtu vetëm
rrezet i pëlqej!...

NË KËNDIN FATLUM

Në këndin fatlum
trimoshi e zonjëmira
sot zunë përpëliten
me ca llafe të lira:

-Zonjushe hiq syzet,
syrin s'po ta shoh.

-Ik trimosh nga unë
unë ty s'po të njoh.

-Jam i ri zonjushe
do ta qaj një dert.
-S'ke pse të pyetësh fare
qarjen gjëje vetë.

-Çantën a ombrellën
inshalla e humb!

-Nuk jam aq harraqe
s'i harroj askund!

-Sa fort më pëlqyeke
flitke mirë e bukur
-Dhe ti mor trimosh
në zemër m'u ke futur.

Në këndin fatlum
këtë ditë fati i poqi
kështu u nxiten n'llafe
zonjëmira e trimoshi!?

PËRJETIMKUJTESE

Kujtoj në përftim
kur zemra i foli zemrës:
çast i hyjnizuar!

Kujtoj gudulisjen
kur goja i tha gojës
për mos t`u harruar!

Kujtoj përjetimin
kur n'agshol të stinës
jetën pamë pranverë

Kujtoj frymëzimin
kur në dridhërim të frymës
mbeti gjurmë me vlerë!

ÇASTRRËFIM

Rrezet në agshol shkëlqejnë
dhe përshëndesin
pranverën e stinës së mbarë.

Sillet pëllumbi plot përgjërim
në faqen e qiellit kaltërosh
para se të kthej në folenë e parë.

Vasha vështron rrebtë pasqyrën
pse një fiye floku padisiplinueshëm
vetull e qepallë ia kish lënduar!

Djalëbardhi me hapa të lehtë,
tinëzisht nga mbrapa
mbështjelli sytë e vashës me rreze praruar...!

Pa diktueshëm dhe duart vashës
ia robëroi
dhe me këtë: çastrrefimi mbaroi...!

PJEKURI ADOLESHENTE

Pse e pandehni
ende të ri,
pse e pandehni
"axhami"?!

Kur ai tash është
mjaft i madh,
mund të ngre kokë,
mbi mur, mbi gardh!

ndenjtur ka me burra
te daja plak,
dredhur ka cigare,
duhan kaçak!

i di "baret"
e di pyllin,
tashmë e ka
të zgjedhur "yllin".

-S'më duhet, thotë, - dije,
s`më duhet shkolla,
tash nevojë kam
veç për ca të holla!

...Dëshiron të lidhë
biznes me "fakte"
pa u lodhur
për mësim me "takte";

mund të lypë qarje
në ekzil në botë
gjëmat e prindve
s`i duron dot!?

FALSLAVDAÇIT

Mos bën llafe
nëpër kafe
gjoja dje
me plot hare
zure gugunë
në fole!

Mos qit fall,
o fatpadalë,
se as sot
as dje as mot
nuk të ka pasë
pushka barot!

Veç fjalë të thata,
sidokrra të gjata,
gjë tjetër s'ke
mbi këtë dhe
rrenët s'mbulohen,
dot, me be!

Trus lavdaç
mos u shit aq
se nuk je
as nuk ke,
t'i njohim dajat
nga i ke!

OI, OI, OBOBO!

-Ua, ua, obobo,
shoh një djalë të bukur-o
që nga mali zdirgjet-o

-Ua, ua, ohoho,
shoh një vashë më të bukurën-o
që nga fusha ngjitet-o!

-Oh, oh, po more jo,
a e merr djalë ti vashën-o
thuaj e do apo s'e do!

-Oh, oh, jo more po,
a e merr vashë ti djalin-o
thuaj e do apo s'e do!

-O ho ho, jo more jo,
s'e merr djali vashën-o
shumë e do, të keqen-o!

-O ho ho, po more jo,
s'e merr vasha djalin-o
e do shumë, fatbardhin-o!

-Oi vërr, oi gërr-gërr
ai s'e merr, ajo s'e merr
vallë, nga polli gjithë ky sherr!

Obobo, oii oii,
me lojëfjalësh, por pa dredhi
u moren ngrykas, tok, të dy!

MËDYZJA Ë ZGJIDHUR

Era loz me valë
vashën pret një djalë...

Do të dalë apo s'do të dalë,
çfarë do të bëhet, vallë!

Erëmon lulevera
me valët loz era...

Me dalë a mos me dalë,
thashtheme valë-valë!...

Buzëbrëmje bregëlumi
ende pret "i lumi"!...

Gonxhja çel nga pushi
zemra ngroh si prushi!

...Prin mendja a ndjenja
në ecjet pa thembra!?

Me dalë e padalë
thashtheme valë-valë...

Era loz me fletë:
vashë e djalë shoh vetë.

Gjethet mëtojnë me valë:
si të thuhet, vallë:

Ka dalë apo s'ka dalë?!

SHIH, UNAZA!

-Shih, shih,
gishti të vezulluaka,
shih, shih,
buza në gaz të shkuaka

e ne fare
gjë s`na thua
kush ta dha, o lumë me krua!

-Lum e lum,
ai lumi i gjatë
ma ka dhënë i imi fat!
Mos dysho,
por dëgjo:
"përshëndetje dhe urime",
kur t`bekohet fejesa ime!

RREZMKUQREMJA

Kur po m`fletë e qetë pa pez'm
po të merr fytyra ngjyra - ngjyra,
lumja ti për lëkuqjen rrezm,
çka dhuratë t'solli natyra.

Atë kuqlim të pamashtri
mos e ndal as mos e tret
se është në vetvete mbretëri
botëfatlumes nur t`i jep.

Ai vështrim, ai farë kuqlimi
robëron e shenjtëron,
shpirt e zemër deh tek trimi
që ngrohësisht të dashuron!

Ngucalemzë, moj, rrezmkuqreme,
pse kaq ndruhesh, pse dyshon
lumturia s`duron dhëmbje
jetën këngë, vallë, s`e dëgjon?!

MOJ E MIRA!

-Moj e mira dritë në terr
a po të marr, moj, a po më merr!

-More i miri dritë në dritë
dhe pak kohë duhesh me pritë.

-Moj e mira, moj e mira
mos m'i shto do net të vështira!

-More i miri, i mirë me nam
unë për të mirë tonën e kam.

-Moj e mira dritë në terr
sot ky nur pse sytë m'i merr?!

-Mos gajlo, terri shpejt hiqet
fryti i mirë vilet kur piqet!...

SYLARUSHË MOJ!

-Sylarushë, me syze të zinj
pse më bën nazë, lum për ty,
pse po i fsheh syçkat me lara
pse s'po këqyr shlir si përpara!

Sylarushë, moj sylarushë
po t'i vërej dhe rruzet në gushë,
kush të "shëmtoj" me këto stoli
kush është ai ta "vras" allti!

-Çka po flet e çka po pvet,
mos të ka lënë mbamendja krejt!?
Syze e rruza vetë m'i ke sjellë
e tash i quan gjëra pa vlerë!

-Desha pak të luaj me fjalë,
po ti mos u preke, vallë,
pa hiq pak syzet këqyr kënde
çdo shikim dua ta shpërblej

jo me pare po me besë graniti,
me dashni që del nga shpirti!

FATLUMI...

Jetë, moj jetë, plot fshehtësi,
si t'lypet fati kur s'di ku rri!?

Me lypë në qiell në tokë të del
me lypë n'dritë, të vjen për terr!
Sa kohë randa pas erës së lules
kur fati më doli në banak të furrës!

E kërkoja në rreze sërish
kur ajo, më doli parasysht!

Jo përftim qielli, po më erdhi n'shpi
me një teze që e kam kojshi!

Jetë, moj jetë plot fshehtësi
lum kush gjen fatin e tij.

Goca e furrës me simite
me mua gëzon q'prej asaj dite!

ZËNKA PËR MAHI!

-O ngrëni tpaemnit,
o pus, o përrua,
krejt ma hëngre shpirtin
prap s'po ngihesh në mua!

Mos ashtu, moj xhane,
mos fol aq me ters
s'dukem i xhindosur
me djall të futem në thes!

-O i ngrëni tpaemnit
që më ke rënë hise
a di se jam femër
dreqin mund të fus n'shishe!

-Dreqin fute në qyp,
mbylle me kapak
unë vras djallin qypin,
dert s'e bëj aspak!

-O i ngrëni t'paemnit
veç sa të vëmë kurorë
se vetë frenjt e vrapit
do t'i mbaj në dorë!

-Vrapit frenjt s'i mbahen
pa praqet përfundi...
sillu urtë e butë
se mund të na marrë lumi!

ANDAJ MË PËLQEVE

Kur të pashë veshë n`kominoshe,
moj e lumja, fatmiroshe,

seç ma zgjove kërshërinë
seç ma shtove simpatinë!

Kur të pashë me mantelpunë,
moj e mira, moj fatlume,

seç ma ntrashe simpatinë
seç ma joshe kërshërinë...

Kur të takova të djersitur
m`u duke dhe më ballëndritur,
andaj shume moj më pëlqeve,
andaj zemrën, moj, ma rrëmbeve!

Dhe unë si ti në punë u rrita
hapa të mbarë sikur ti qita,

andaj zemrën moj ma rrëmbeve
andaj shumë moj më pëlqeve!

Moj ballëndritura fatmiroshe
n`punë e veshur me kominoshe

punë të mbarë, moj, të përgëzoj
zemra më flet, shumë të adhuroj!

SPROVË AKTORIMI...

-More hej, vallë, nuk po më sheh,
gati më shkele, a s'po më njeh!

-Ua, më fal, e pabesuar
për një natë paske ndryshuar:
solemn robe paske veshur
fustan të bardhë, jo aq të ngjeshur;
qenke bërë si princeshë në përrallë
ku të gjejmë princin, sokol djalë!

-Krejt pas kodre mos më hidh mua,
përralla të thata më nuk dua,
tash jam në rolin e vërtetë
sokol dua, princeshë jam vetë!

-Sokol unë, princeshë të kam ty:
përralla në shkallë, dukati n'gji!

Djalë fatbardhi në rol princi
vashë aktresha, lule fisi,
skeçin luajtën për mrekulli
jo veç në skenë por dhe n'shtëpi!

MOLLZKUQREMJA

Me pikë në faqe, mollzkuqreme
mjaft më përflake mendjen teme;

me ata sy, vetullat çapraz
mos m'í shto shpirtit maraz;

me atë shtat, me atë ecje,
pse më ysht më bën për vete;

po ato flokë, pse i cube vallë,
deshe rrudhë t'më vësh në ballë?!

-Jo s`të ysht, as s`të shtoj rrudhë,
flok`t shpejt rriten, djaloburrë;

pika në faqe e buzër në gaz
s`di pse i shtojnë dikuj maraz?!

N`se fshij pikën më çilet vrragë;
të ndal buzëqeshjen m`hapet plagë...

a të shëmtoj vet`lla, shtat e këmbë
për t`qetësuar atë shpirtin tënd!?

-Mollzkuqreme, me pikë në faqe
që më shastise dhe shumë m`kënaqe,

t`i lëmë zënkat, mahitë më fjalë,
t`shuajmë bashkë flakën mos t`na kallë!

NUSEZONJË

Si dallëndyshe,
me sytë shqiponjë,
je zonjushe
do të quaj zonjë...

fët e fët
në timen botë
erdhe u fute
ashtu ngrohtë

dhe m`u bëre
thesar jete,
njeri erdhe,
njeri mbete;

si dallëndyshe
me sytë shqiponjë
shoqebardha
nusezonjë!

DASHURI, KËNGË, GUMËZHIMË

Djalë e vashë dallues në uzinë
punojnë, gëzojnë për lumturinë.

Sa u kanë hije kominoshet,
balli u ndrit, fytyra u joshet;

frezat në duar lehtë u zhurmojnë
bëjnë pistonet të "dëgjojnë".

Dashuria kur n`zgjim gërget,
ngazëllen zemrat, syri flet;

kënaqësi shton dhe puna e vyer
me vullnetin e shkëlqyer;

më lehtë norma tejkalohet
kur me rrezm, mirënjohja ngrohet...

Ca ngucaqë fjalëtojnë më kot,
-Sa shpesh duken këta dy tok?

Vjen përgjigjja në gjuhë zemre
-Dashuri pa thashetheme,

ëmbël jeta u buzëqeshi
lumturinë gaz ua mveshi!

S`vonoi çifti dasmën bëri
nga ahengu "u tund vendi"!

...Në uzinë ndriti fati i bardhë,
gëzojnë sot çiftet: nuse e djalë;

frezat në duar lehtë u përdridhen,
gumëzhimë e këngë përzihen.

KUJTOJ...

Kujtoj çfarë kujtoj
kujtimi vetë vjen;
të flas çfarë të flas
kur fjala në vete zien!

Kujtoj pra në çaste
jetën poezi,
kujtoj dhe ca vargje
lule-dashuri!

Si na ikën çastet
ashtu fët e fët
sa çil e mbyll syrin
fjalët na lanë shkret!

Fët e fët kujtohet
ndonjë fjalë murrize
që s'di si u vollën
në ato çaste krize!

Kujtoj pas rrebeshit
dhe ujë me qetë rridhte
porse sedërgrisura
çilgurgojën s'fliste!

por me t'kaluar koha
rahmetin e sillte,
kujtoj pas lezetin
që mjaft me bujë vinte!

Kujtoj çfarë të kujtoj
stina e moshës s'kthen
por të gjitha së bashku
dashnia i mbërthen!

KËSHILLË GJYSHORE

Ju të rinj, kujtoni shpesh
fjalët e gjyshit, vëthë në vesh:

gruaja burrin e bën guri
n'lypt me i ra kokës për muri;
burri gruan e bën me kupë
n'se do fjalët t'ia mbyllë me shtupë.

Mbanie mend se kjo s'është lojë
burri gruan mund ta bëjë zonjë,
por dhe gruaja e mbarë me qenë
e bën burrin me u përmendë!

Po n'se u humbet mirëkuptimi
shpisë për së brendshmi i del tymi

Andaj kujdes ju të rinj e të reja
mirëkuptim të keni përhera!

**Rifat Kukaj, FRYMËZIME QË PREKIN MENDJEN
DHE SHPIRTIN E TË RINJVE**

(recension)

Gjatë leximit të këtij vëllimi poetik, *Bulëza të përshenjura* (poezi) të Nuhi Veselajt, shihet qartë a fitohet bindja se autori frymëzimet i ka mbajtur për një kohë të gjatë në vete dhe, gjithsesi vetëm pasi janë pjekur, i ka shkruar. Vargjet rrezellijnë dashuri, shqetësim dhe fshehtësi të një shtegu të rrëpinjtë nëpër të cilin fëmijët, që tanimë i kanë thënë lamtumirë lodrës, përrallës etj., zënë të hetojnë thellë në shpirt si diçka të tillë. Kjo moshë adoleshente përherë ka shqetësuar edhe shumë poetë për t'i kënduar, sepse në njëfarë dore kujtojnë dhe bulëzat e veta të një kohe të shkuar. Do të thosha që këto kujtime, me ca variacione kanë bërë që vepra të dalë e arrirë dhe poezitë të jenë tërë këlthitje, lirikë, po në çaste edhe rrufe...

Në shkrimet për dashurinë, për mendimin tim përherë paraqitet një "rrezik" që: të mos ngatërrohen erotika me pornografinë. Për fat të mirë, autori ka pasur kujdes dhe ka ruajtur ndjenjën e masës. *Bulëzat* që prekin mendjen dhe shpirtin e të riut, i cili po njihet me diçka të re, tronditëse e të këndshme, reflektohen në vargje dhe janë stoli të zgjedhura me shije. Mendoj që autori është ruajtur mirë që të mos e qëndis tepër "pëlhurën" d.m.th. temën për të mos u parë. Pra ka stoli aq sa i duhet veprës, duke mos u larguar as nga tema boshte - dashuria, as nga normat estetike.

Ndër të veçantat që ka ky vëllim me poezi për dashurinë, në fakt për zanafillën e dashurisë si ngjarje e shënuar në jetën e të rinjve, është, se kjo temë, me gjithë mend, deri vonë ishte shumë delikate për t'u trajtuar. Kemi fare pak libra kushtuar kësaj teme.

Kam bindjen se lexuesi i ri duke parë *bulëzat* nëpër këto vargje do t'i ndjejë e përjetojë ato thellë në shpirt, në mendje e në zemër dhe do të dijë t'i çmojë dhe respektojë, sepse nuk ka dhunti më të madhe se dashuria, por njëherit nuk ka gjë më të vështirë se sa ta ruajsh atë. Është njësoj si të pikasësh me tërë genien mufatjen e sythave e të mos i lëndosh ato.

Librin e propozoj me kënaqësi për botim.

Prishtinë, prill - 2000

SHËNIME PËR AUTORIN

Nuhi VESELAJ u lind në fshatin Reçan të Suharekës, më 20.VIII.1933. Shkollën fillore e kreu në Suharekë në vitin 1948, ndërsa Shkollën normale në Gjakovë, ku maturoi më 30.VI.1952.

Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe e kreu më 23.IX.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe më 23.IX.1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 3.IV.1980 mori gradën: magjistër i shkencave dilologjike, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 24.XII.1992. Punoi në arsim s(hkolla): Mushtisht, Grejçec, Muzeqinë, Ferizaj, Zllatar, Tankosiq, Prishtinë. Pasi e përjashtuan nga arsimi një kohë punoi si referent në "Partrizanski put" të Beogradit - filiala në Prishtinë pastaj në uzinën "Amortizatorët" të Prishtinës, ku edhe u pensionua. Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj, me seli në Tiranë.

Nuhi është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye të ndryshme s'ka mundur t'i botojë të gjitha dorëshkrimet.

Deri tashti botoi këto vepra:

1. *Miklime* (vjersha) (1967) (ribotim) (1997);
2. *Rrezet e Ylberta* (vjersha) (1971) (ribotim) (1997);
3. *Me buzët në gaz* (vjersha) (1997);
4. *Fletë ditari rreth një motmotari* (vjersha) (1997)
5. *Trimoshi* (tregime për fëmijë dhe të rinj) (1997);
6. *Cace e hope djaloshare* (poezi) (1997);
7. *Shfrime nëpër mjegullnajë* (poezi) (1997);
8. *Gërricje në damarët e djalërisë* (tregime) (1998);
9. *Mësime nëpër pësime* (shfaqje teatrore) (1998);
10. *Ther me pupël* (vjersha të ngjyera me humor), Prishtinë 2000;
11. *Bulëza të përshenjura* (vjersha të një "babamësuesi" kushtuar stinës rinore), Prishtinë 2000;
12. *Vëllimin e parë të veprës gjuhësore "Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit"* (1997);
13. *Paskajorja - çështje e shqipes letrare*, Prishtinë 2000.

Pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera qoftë nga fusha letrare-artistike, qoftë nga ajo shkencore-gjuhësore.

P ë r m b a j t j a

Parathënie

Dy fjalë përpara
Vjershëtarit të ri
Bulëzat e përshenjura
Mirëmëngjesi!
Pyetje e rëndë
"Lulet mujore"!
Çuni burrosh
Dhe këto gocat
Dhe këta çunat
Vallë si quhet?
Gazdashnia
Dehje magjike
Fjalë goce!...
Shoku i pashok
Qenë pesë goca!
Telepatikja
Kujdes, bijo!
Ah, qerpiku!...
Zënka
Dy shoqe të pandara
E di...
Për rinjohje!
Kurora e përjetësisë
Fryti i bekuar
Bisedë me gjyshin
Portreti i pëlqyer
Çfarë do?...
Dridhërimë e afshtë
Nën afsh
Solli era...
Atëherë...
Fjalë pa bisht!...
Çast...
Çfarë ndodhi?
Kitaristi
Trazim i këndshëm
Përshëndetje
Më thuaj?!
Lapsa grimimi

Vajzë Flamurja
"Marrelia" i lyster me vaj
"Mësimi" në natyrë
Moj flokëkrehura!
Për leshrat në erë
Buzëqeshje e magjepsur
Stoli mbi stoli
Sixhelozka
Ndjenjarta
Pse?
Në takim
Magjepsia
Në mes të orëve
Në mbrëmje vallëzim
Çast humbëtie
Dialog
Përhitje në kalim
Dhuratë ndjesie
Pushi e prishi magjik
Mendjelehta!
Sprova
Harraqi
Përgjumësim
Tretje disponimi
Qëndrim enigmatik
Gonxhe, moj!...
Dhuratë këngëtari
Idilë bashkëkohore
Idilë fshati
Ëndërrimi i kostarit
Rrezja në dritare
Në këndin fatlum
Përjetim kujtesë
Çastrëfim
Pjekuri adoleshente!
Falslavdaçi
Oi, oi, obobo!
Dilema e zgjidhur
Shih, unaza!
Rrezmkuqremja
Moj e mira
Sylarushë, moj
Fatlumi
Zënka për mahi

Andaj më pëlqeve

Provë aktorimi

Mollzkuqremja

Nusezonjë

Dashuri, këngë e gumëzhimë

Kujtoj

Këshillë gjyshore

Rifat Kukaj, Frymëzime që prekin mendjen dhe shpirtin e të rinjve (recension)

Shënime për autorin